



REPUBLIKE E SHQIPERISE

BASHKIA FIER

Nr. 9620 prot

Fier, më 22.08.2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 46, datë 22.08.2025

“PËR

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI
SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË
VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR RRIJTJEN E KAPACITETEVE TE QEVERISJES
VENDORE, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES
VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (TALGA)”**

Në mbështetje të nenit 2, pika 11, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.6, shkronja “b”, nenit 14 pika 5, neni 51 pika 4, nenit 54, shkronja “d” dhe “gj”, nenit 55 pikat 3, neni 64 shkronja “h”, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), Ligjit Nr. 8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”, Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” (i ndryshuar), Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 16.07.2025 “Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”,

PROPOZJMË:

1. Të miratojë marrëveshjen (tip) për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta (SKP), në formën e organizatë jofitimprurëse me anëtarësi, midis njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, dhe anëtarësimin e Bashkisë Fier në SKP, të quajtur “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, bazuar në statutin dhe aktin e themelimit bashkëlidhur këtij vendimi”.

TALGA do të ketë si mision zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të njësive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi, me qëllim rritjen e performancës profesionale të tyre për t'i shërbyer cilësisht komuniteteve, për të përmbushur funksionet dhe kompetencat ligjore të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV), si dhe për të përballuar me sukses sfidat e NJVV-ve në procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në kuadër të misionit të saj TALGA bën vlerësim të nevojave për trajnim, harton programe trajnimi dhe planet e trajnimeve, administron dhënjen e trajnimeve të vazhdueshme dhe të tjera, përcakton kriteret dhe bën përzgjedhjen e pjesëmarrësve në trajnime, krijon rrjetet e zyrtarëve vendorë për shpërndarjen e njohurive dhe praktikave të mira, administron një platformë të menaxhimit dhe ndarjes së njohurive për zyrtarët e NJVV-ve dhe të interesuar në sektorin e qeverisjes vendore, harton dhe zbaton projekte dhe aktivitetet në fushën e veprimtarisë së TALGA, ofron ekspertizë dhe shërbime konsulence ndaj NJVV-ve, bashkëpunon me organizata homologe dhe partnerë të ndryshëm për realizimin emisionit të saj, kryen studime dhe zhvillon dokumente politikash në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të zyrtarëve të NJVV-ve.

2. Të miratojë aktin e themelimit të TALGA-s dhe përfaqësimin e Bashkisë Fier në TALGA (SKP), sipas përcaktimeve të statutit të TALGA-s dhe të marrëveshjes (tip) bashkëlidhur;
3. Të miratojë efektet financiare të anëtarësimit të Bashkisë Fier si anëtare e TALGA (SKP) dhe detyrimin përkatës të pagesës vjetore të kuotës së anëtarësisë, nga fondi i parashikuar për trajnimet në buxhetin e vitit 2025 dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025–2027, dhe në shumën e përlogaritur në përputhje me planin e financimit të përbashkët të Këshillit të Ministrave dhe të NJVV-të e tjera anëtare dhe vendimit përkatës së Asamblesë të Përgjithshme të TALGA. Efektet financiare për anëtarësimit dhe detyrimet e pagesave vjetore ndaj TALGA, për tri vitet e para e në vijim, do të përballohen nga të ardhurat e veta të bashkisë.
4. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Fier të nënshkruaj marrëveshjen ndërmjet ministrit përgjegjës për çështjet vendore, i autorizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405 dt. 16.07.2025 *“Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”* dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, sipas tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe administrative dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentet administrative për regjistrimin, ngritjen dhe funksionimin e TALGA-s, në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit, bashkëlidhur këtij vendimmi, si dhe vendimeve të Asamblesë të TALGA-s;

5. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Fier të përfaqësojë Bashkinë Fier në organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe organe të tjera të ngritura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA, si dhe të realizojë çdo veprim tjetër për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe për përmbushjen e detyrimeve që i ngarkohen Bashkisë Fier nga kjo marrëveshje, në përputhje me Statutin dhe vendimet e Asamblesë të TALGA.
6. Ngarkohet Kryetari Bashkisë, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit të Bashkisë Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Drejtoria e Financë Buxhet e Kontabilitet
Pranvera Çina

Drejtoria Juridike
Esmeralda Kapllanaj

KRYETAR
Armando Subashi

